



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 320/2015
18 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK) në bazë të nenit 108 Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 03 /L 223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ne takimin e datës 18 nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen ndryshimet dhe plotësimet në Udhëzimin Administrativ për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 01/2015 për zbatimin e vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për bartjen e përgjegjësive nga SKGJK-ja në Gjykata.
2. Autorizohet Sekretariati i KGJK-së që të publikoj këtë Udhëzim Administrativ në Ueb faqe të KGJK-së.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Sekretariati i KGJK-së konform nenit 27, paragrafi 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ka propozuar Këshillit Gjyqësor ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 01/2015 për delegimin e përgjegjësive nga Sekretariati tek gjykatat në fushën e personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës. Ky propozim, është në funksion të ngritjes së efikasitet të gjykatave pasi që propozimi ka të bëjë me bartje shtesë të përgjegjësive nga SKGJK tek gjykatat ne procedurën e rekrutimit.

Më konkretisht, ky propozim ka të bëjë me autorizime shtesë gjykatave që gjate procesit të rekrutimit kërkesën për miratim ta dërgojnë direkt ne MAP jo përmes SKGJK si aktualisht e rregullon Udhëzimi Administrativ 01/2015.

Së këndejmi, u propozua që ndryshimet dhe plotësimet ne Udhëzimin Administrativ (01/2015) të jenë si në vijim:

- I. Neni 5 i Udhëzimi Administrativ 01/2015 të ndryshohet si në vijim:

Neni 5

5.1 Kërkesa për inicim të procedurës së rekrutimit, bëhet përmes Menaxherit të personelit të aprovuar nga Udhëheqësi më i lartë administrativ i

gjykatës e cila përcillet tek MAP-DASHC, për marrjen e pëlqimit për lejin e shpalljes së vendi të lirë të punës.

5.2. Gjykata, para se të dërgoj me tutje kërkesën për inicim të procedurës së rekrutimit e verifikon se a është kërkesa konform sipas strukturës organizative të miratuar nga KGJK dhe se pozita e kërkuar është e lirë.

5.3 Menaxheri i personelit të gjykatës mund të kërkojë nga Udhëheqësi i Njësisë në të cilën plotësohet pozita e lirë , që të ofrojë sqarime shtesë dhe ndryshime e plotësime në kërkesën për inicimin e procedurës së rekrutimit, nëse informatat e parashtruara në kërkesë nuk janë në përputhje me nenin 9 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit.

5.4 Sqarimet, ndryshimet dhe plotësimet përkatëse , duhet dorëzuar te menaxheri i personelit të gjykatës brenda 5 ditë pune, nga dita e kërkesës për sqarime

5.5 Nëse iniciuesi i kërkesës nuk i përgjigjet kërkesë së menaxheri të personelit gjykatës për sqarime, kërkesa nuk do të procedohet më tutje.

5.6 . [Nuk ndryshohet]

II. Tek Neni 6 propozohet të ndryshohet vetëm pika 6.2 me tekstin si ne vijim:

6.2 Për rihapjen e procedurës së rekrutimit, nevojitet një kërkesë nga udhëheqësi i njësisë që të i dorëzohet menaxherit të personelit, së bashku me të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm.

III. Ndërsa neni 7 të riformulohet si ne vijim:

Pas kompletimit të kërkesës, menaxheri i personelit të gjykatës e dërgon për miratim përfundimtar në MAP.

Andaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke parë se SKGJK me këtë propozim kërkon që të bart edhe më tepër përgjegjësi tek gjykatat me qëllim të ngritjes së efikasitetit në gjykata sa i përket procedurave të rekrutimit, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Gjykatave
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 321/2015
Datë, 18 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS në bazë të nenit 108, paragrafi 5 dhe 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 3 të Ligjit 05/L-033 përmes së cilit është bërë plotësimi dhe ndryshimi i nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe nenit 10 paragrafi 3 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja 17/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 02/2015 për përzgjedhjen e anëtareve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga gjyqësori.
2. Autorizohet Sekretariati i KGJK-së që të këtë rregullore në Ueb faqe të KGJK-së.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Enver Peçi,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Departamentit Ligjor SKGJK



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 322/2015
Datë, 18 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat, dhe nenet 41-45 Rregullores mbi Organizmin e Brendshëm të Gjykatave pas diskutimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit Burim Emërllahu për transfer nga Gjykata Themelore në Gjilan në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e z. Burim Emërllahu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan për transfer në Gjykatën Themelore në Ferizaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Me shkresën e datë 07.08.2015, gjyqtari Burim Emërllahu ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të bëjë transferimin e tij nga Gjykata Themelore në Gjilan në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Më shkresën GJ.A. Nr.201/15 të datës 12.10.2015, kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan ka dhënë pëlqimin për transferin e gjyqtarit Burim Emërllahu nga Gjykata Themelore në Gjilan në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Këshilli Gjyqësor në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015 shqyrtoj kërkesën e gjyqtarit Emërllahu dhe vendosi që ta aprovoj atë duke marr parasysh pëlqimin e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Ne funksion të gjetjes së një zgjidhje të drejtë dhe ligjore Këshilli Gjyqësor vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Burim Emërllahu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan
- Z. Zyhdë Haziri, kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan
- Z. Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj
- Sekretariatit të KGJK-së



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 323/2015
Datë, 18 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat, dhe nenet 41-45 Rregullores mbi Organizmin e Brendshëm të Gjykatave pas diskutimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit Venhar Salihu për transfer nga Gjykata Themelore në Ferizaj në Gjykatën Themelore në Gjilan, në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e z. Venhar Salihu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj për transfer në Gjykatën Themelore në Gjilan.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Me shkresën e datë 23.07.2015, gjyqtari Venhar Salihu ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të bëjë transferimin e tij nga Gjykata Themelore në Ferizaj në Gjykatën Themelore në Gjilan. Më shkresën Gj.A.Nr.346/15 të datës 12.10.2015, kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj ka dhënë pëlqimin për transferin e gjyqtarit Venhar Salihu nga Gjykata Themelore në Ferizaj në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Këshilli Gjyqësor në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015 shqyrtoj kërkesën e gjyqtarit Salihu dhe vendosi që ta aprovoj atë duke marr parasysh pëlqimin e kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Në funksion të gjetjes së një zgjidhje të drejtë dhe ligjore Këshilli Gjyqësor vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Venhar Salihu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj
- Z. Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj
- Z. Zyhdë Haziri, kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan
- Sekretariatit të KGJK-së



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 324/2015

Datë, 18 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 104 pika 1 dhe nenit 108 pika 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1.2 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe nenit 12 të Rregullores për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtareve, pasi shqyrtoi rekomandimet e Panelit të Shqyrtimit të Aplikacioneve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për kandidatët për gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015, nxori këtë:

VENDIM

1. Znj. Manushe Karaçi propozohet të emërohet gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARSYETIM

Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve pas konsultimit të dosjeve të vlerësimit të performancës, intervistimit dhe verifikimit gjithëpërfshirës të gjyqtarëve të cilët kanë aplikuar për ngritje në detyrë ia dërgoj Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin e përgjithshëm të përzgjedhjes së kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 18 nëntor 2015 pas shqyrtimit të raportit të përgjithshëm dhe rekomandimit të Panelit për Shqyrtimin e Aplikacioneve vendosi që të propozon Presidentes së Republikës së Kosovës që të emëroj znj. Manushe Karaçi gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Andaj, nga se u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi:



Vendimi i dërgohet:

1. Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës
2. Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
3. Arkivit të KGJK-së



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 325/2015

Datë, 18 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 104 pika 1 dhe nenit 108 pika 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1.2 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe nenit 12 të Rregullores për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtareve, pasi shqyrtoi rekomandimet e Panelit të Shqyrtimit të Aplikacioneve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për kandidatët për gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në mbledhjen e mbajtur me 18 nëntor 2015, nxori këtë:

V E N D I M

1. Znj. Hajrie Shala propozohet të emërohet gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A R S Y E T I M

Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve pas konsultimit të dosjeve të vlerësimit të performancës, intervistimit dhe verifikimit gjithëpërfshirës të gjyqtarëve të cilët kanë aplikuar për ngritje në detyrë ia dërgoj Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin e përgjithshëm të përzgjedhjes së kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 18 nëntor 2015 pas shqyrtimit të raportit të përgjithshëm dhe rekomandimit të Panelit për Shqyrtimin e Aplikacioneve vendosi që të propozon Presidentes së Republikës së Kosovës që të emëroj znj. Hajrie Shala gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Andaj, nga se u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i dërgohet:

1. Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës
2. Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
3. Arkivit të KGJK-së